



Biznes Plani

K.R. “Hidroregjioni Jugor” Sh.A. Prizren

2009 - 2011



1. PERMBLEDHJA E PERGJITHSHME

1.1	Historiku i kompanise	3
1.2	Deklarata e politikës	4
1.2.1	Deklarata e misionit	4
1.2.2	Deklarata e riskut (rrezikut)	5
1.2.3	Tarifat e shërbimit	5
1.3	Qëllimet dhe objektivat strategjike	6

2. PLANI I SHËRBIMEVE NDAJ KONSUMATORËVE

2.1	Planifikimi numrit të konsumatorëve	8
2.2	Planifikimi i faturimit dhe arkëtimit	8

3. PLANI OPERATIV

3.1	Aktivitetet kryesore operative	13
3.2	Planifikimi i Menagjimit të aseteve	15

4. PLANI FINANCIAR

4.1	Analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve	21
4.2	Pasqyrat Financiare – (Balanci gjendjes- Pasqyra e të ardhurave)	26

5. PLANI I ZHVILLIMIT TE STAFIT

5.1	Kërkesa e stafit	28
5.2	Struktura e re organizative	29
5.3	Trajnimi i stafit	31

6. PLANI I INVESTIMEVE

6.1	Plani i investimeve në 2009	32
-----	-----------------------------	----

Annex I Te dhenat dhe treguesit e performances per vitin 2009 (sipas muajve)

Annex II Te dhenat dhe treguesit e performances per vitin 2009, 2010, 2011

1. PERMBLEDHJA E PERGJITHSHME

1.1 Historiku i Kompanise

Ne vitin 1962 ka filluar te ushtroje veprimtarine e saj si ndermarrje Shoqerore e njohur me emrin "Cvileni", qe nga viti 1999 ka funksionuar si Ndermarrje Publike nen DSHP shtylla e IV e UNMIK-ut, ndersa qe nga mesi i vitit 2003 kjo Kompani eshte regjionalizuar me 4 njesi ne vete: Prizren, Suhareke, Dragash dhe Malisheve.

Qe nga Korriku i vitit 2007 funksionon si Korporate rajonale "Hidroregjioni Jugor" SH.A.

Kompania e ujesjellesit rajonal Hidroregjioni Jugor, sherbimet e veta i ofron ne pjesen jugore te Kosoves duke perfshire keto komuna:

- Prizrenin
- Suhareken
- Dragashin
- Malisheven

Rrjeti furnizues qe i kryen sherbimet perfshine 4 njesi operacionale: Njesine Prizren, Suhareke, Dragash dhe Malisheve. Furnizimi me uje behet prej burimeve vetanake. Ne nivel te Kompanise furnizohen edhe 22 fshatra qe jane te kyçur ne rrjetin e Kompanise Regjionale Prizren, Suhareke, Malisheve. Numri i popullates ne te cilen Kompania e Ujesjellesit Regjional Prizren i kryen sherbimet e veta vleresohet te jete rreth 200.000 banore.

Kapaciteti momental prodhues sillet rreth 850 l/sec., deponimet e ujit 10.000 m³, rrjeti distributiv $\Phi 50$ - $\Phi 600$ L=224 km, rrjeti i kanalizimit $\Phi 200$ - $\Phi 1500$ L=151 km. Qytetit furnizohet 60% me pompa, 40% me gravitet. Stacionet e pompave jane ne Njesine e Prizrenit: Bunarlek I, Bunarlek II, Sozi-Nashec, Vermice, Konjush I, Konjush II, ne njesine e Suharekes burimi Pusi i atit, Savrova, Topallnica dhe Fidanishte, ne njesine e Dragashit burimi Radesha, ne njesine e Malisheves burimi Banje.

Ne kete Kompani ekzistojne 2 trafostacione me fuqi N=630

Kompania Regjionale Prizren ka nje fabrike per trajtimin e ujit ne Njesine e Prizrenit me kapacitet 150 l/sec.

1.2 Deklarata e politikës

Menagjimenti i KUR "Hidroregjioni Jugor" SH.A. i përkrahur nga palët e interesit (Bordi i Drejtorëve, aksionarët, konsumatorët etj) dhe me ndihmën e të gjithë punëmarrësve kanë për qëllim furnizimin me ujë pa ndërprerë të të gjithë konsumatorëve në zonën e shërbimit.

Të vetëdijshëm se në kushtet e tanishme kjo është një gjë e pamundur do të vihen në dispozicion të gjitha burimet njerezore dhe burimet financiare që të minimizohen humbjet teknike dhe zhduken në tërësi humbjet administrative të ujit nga njëra anë dhe të maksimalizohen të gjitha aktivitetet lidhur me rritjen e shkallës së arkëtimit.

Prandaj është një prioritet i përcaktuar zvogelimi i sasisë së ujit pa të ardhura dhe pagesa për shërbimet.

Përmes këtyre aktiviteteve në të ardhmen do të krijohen kushte të favorshme për rritjen e nivelit të investimeve nga burimet vetanake.

Përmbushja e një vizioni të tillë do të krijonte parakushte më të mira për investime nga donatorët dhe agjensionet tjera financiare.

1.2.1 Deklarata e "misionit"

Misioni i KUR "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. është: furnizimi me ujë të pijshëm, largimi i ujërave të ndotura, mirëmbajtja e rrjetit të ujit të pijshëm si dhe mirëmbajtja e rrjetit të ujërave të ndotura.

Orientimi i aktiviteteve të punës do ta ketë konsumatorin në qendër të vëmendjes. Të gjithë konsumatorët do të kenë trajtim dhe çasje në shërbim: pa diskriminim racor, pa diskriminim në përkatësinë religjioze, pa diskriminim në përkatësinë kombëtare, pa diskriminim në përkatësinë gjinore.

Duke përmbushur këtë "mision" do të bëhet i mundur sigurimi i një aktiviteti pjesërisht të vetëfinancueshëm me qëllimin e fundit që të sigurojmë shërbime cilësore të ujit të pijshëm në pajtim me standardet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Çasja e afarizmit të kompanisë do të jetë transparente dhe e bazuar në dispozitat ligjore. Kjo do të bëhet në bashkëpunim me palët e interesit:

- Punëmarrësit,
- Aksionarët-Bordin e Drejtorëve - Qeveria
- Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor,
- Ministrinë për Ekonomi dhe Financa,
- Zyrën Rregullative për Ujë dhe Mbeturina
- Konsumatorët (të organizuar në komisione, shoqata etj).

1.2.2 Deklarata e riskut (rrezikut)

Përgaditjes së këtij Planit të Biznesit i është casur nga parimi i vazhdueshmërisë dhe zhvillimi i aktiviteteve biznesore në një periudhë të gjatë kohore. Rreziqet e mundshme në aspektin e parashikimit për periudhën në të cilën bëhet ky plan i biznesit dhe pamundësia e realizimit të tij mund të përmblihen në:

Mungesën e burimeve-rezervave të ujit (si pasojë e reshjeve atmosferike),

Lëvizjet sociale,

Forcat tjera madhore (termeti, vërshimet, zjarret etj)

1.2.3 Tarifat e shërbimit

Kompania KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. do të zbatojë tarifën e çmimeve që do të vendosë Zyra Rregullative për Ujë dhe Mbeturina conform Ligjit N 03/L-086 si autoritet i vetëm dhe kompetent për përcaktimin e tarifave. Në bazë të kësaj Rregulloreje është e përcaktuar "mbulimi i të gjitha kostove të operimit dhe investimeve"

Konsiderojmë se me tarifën ekzistuese është e mundur të arrihej vetëm mbulimi i kostove operative por jo edhe kostove të investimeve kapitale. Kjo nënkupton se tarifa ekzistuese përveq tjerave është pengesë për investime më të mëdha drejt përmirimit të bazës materiale dhe për shërbime më të mira për konsumatorët..

Menagjmenti i KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. planifikon që gjatë vitit 2009 të kërkojë korrigjimin e tarifës ekzistuese minimum për një rritje prej mesatarisht 25 %.

Rritja e planifikuar që gjithsesi do të bëhet në bashkërendimin e aktiviteteve me ZRRUM-in do të jetë ekskluzivisht në funksion të rritjes së investimeve kapitale dhe përpjekjes për bashkëfinancimin e shumë projekteve të mundshme kapitale me komunitetin, me komunat përkatëse dhe me donatorët.

Rritja e tarifës është e domosdoshme për shkak të:

- Rritjes së çmimit të energjisë elektrike
- Rritjes së çmimit të karburanteve
- Rritjes së vlerës së shërbimeve nga palët e treta.

Rritja e tarifës do të ndikojë pozitivisht dhe do të mobilizojë menagjmentin dhe personelin tjetër në KUR "Hidroregjioni Jugor" SH.A. në përmbushjen me sukses të misionit të përcaktuar.

Rritja e tarifës do të ketë efekt në stimulimin e kursimit të ujit në dobi të konsumatorit nga njëra anë (direkt) dhe nga ana tjetër do të ketë përfitime indirekte përmes kthimit të të njejtës në shërbime më të mira.

TARIFAT EKZISTUESE PËR SHËRBIMET E UJIT DHE UJËRAT TË ZEZA

Kategoria e konsumatorit	Tarifa fikse (Euro/muaj)	Tarifa volumetrike per ujë të pijes (Euro/m3)	Tarifa volumetrike të ujërave të zeza (Eurom3)
Konsumatori Shtëpiak	1.0	0.19	0.05
Konsumatori Komercial/Industrial	2.0	0.40	0.05
Konsumatori institucional	2.0	0.40	0.05



1.3 Qellimet dhe objektivat strategjike

Si qellime kryesore te KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A. jane:

- Kontinuiteti i vazhdueshëm i prodhimit te ujit të pijshëm,
- Kontrolla e kualitetit të ujit të pijshëm të jetë në pajtim me instruksionet e leshuara nga rregullorret në fuqi.
- Rritja e shkalles se inkasimit si dhe zvogelimi i ujit te pafaturuar
- Rritja e shkalles se efikasitetit te punetoreve.

Si objektiva kryesore te KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A jane:

- Mirëmbajtja e stabilimenteve Elektro-makinerike,
- Mirëmbajtja e rrjetit të ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza me qëllim të zvogëlimit të humbjeve në rrjet dhe evitimin e prishjeve më kohë,
- Aktivitetet në përfundimin e projekteve për instalimin e ujëmatësave,
- Përpjekjet që çdo konsumatori ti matet sasia e ujit të shpenzuar dhe ti bëhet faturimi në bazë të sasisë së ujit të shpenzuar,
- Pasurimi i Sistemit Gjeografik të Informimit me të dhena të reja,
- Përpjekjet maksimale në identifikimin e klientëve të rinje,
- Angazhimi në mbledhjen e borgjeve të vjetëra si dhe inkasimi i faturave rrjedhese,
- Identifikimi dhe rritja e numrit te konsumatoreve perfshire ketu edhe lidhjet ilegale,
- Vazhdimi i informimit të konsumatorëve dhe bashkëpunimi me organet komunale ne menyre që shfrytëzimi i ujit të bëhet në suaza normale,
- Trajnimi i kuadrove në fusha të ndryshme si: në teknologjitë bashkekohore të trajtimit të ujerave të pijshëm dhe ujerave të zeza, në fushën e ekonomisë, financave, etj.

2. PLANI I SHËRBIMEVE NDAJ KONSUMATORËVE

Kompania gjatë vitit 2008 ka qenë e përkushtuar që ti kushtojë një rëndësi të veçantë përmirësimit të shërbimit me konsumatorë. Ky përkushtim do të jetë shumë më i madh, sidomos në vitet 2009 – 2011. Jo kot gjermanët thonë se „Konsumatori është mbret” ndërsa japonezët shkojnë edhe më larg ku thonë se „Konsumatori për ne është zot”. Përmirësimi i shërbimeve ndaj konsumatorëve jo vetëm që është domosdoshmëri por do të jetë bazë fundamentale e arritjes së objektivave të kompanisë. Një prioritet i veçantë i kompanisë do të jetë plotësimi i të gjitha standardeve të kërkuar nga Zyra Rregullative.

Gjatë vitit 2009 Kompania do të përgatis dhe fillojë më implemetin e plotë të gjitha procedurave ligjore.

Në kuadër të përmirësimit i shërbimeve ndaj konsumatorëve kompania ka planifikuar masa konkrete që do të fillojnë të implementohen si:

Funksionimi i plotë i shërbimit për konsumatorë

Caktimi i veçantë i zyrës për konsumatorë me të gjithë infrastrukturën e domosdoshme

Përmirësimi i komunikimit me konsumatorë

Caktimi i personit përgjegjës kontaktues, ku konsumatorët do të kenë mundësi të marrin të gjitha informacionet e nevojshme.

Kontaktet e vazhdueshme me të gjitha mjetet e informimit.

Organizimi i emisioneve të drejtpërdrejta për konsumatorë (një herë në muaj) në TV lokale.

Informata të rregullta për konsumator, në radio lokale (së paku dy herë në javë).

Përgatitja e broshurës për konsumatorë ku do të precizohen të drejtat dhe obligimet e ndërsjella të kompanisë dhe konsumatorëve.

Vizita e konsumatorëve dhe kontaktet direkte në të gjitha zonat e furnizimit.

Rritja e vetëdijesimit të konsumatorëve

Përmes kontakteve të vazhdueshme dhe informatave të rregullta do të përmirësohet edhe vetëdijesimi i konsumatorëve në ruajtjen apo shfrytëzimin sa më racional të ujit të pijes por edhe në rritjen e moralit të pagesave.

Në këtë drejtim do të organizohen projekte të veçanta në bashkëpunim edhe me institucionet tjera, si në shkollat e ciklit të ulët dhe ato të mesme. Këto projekte do të kenë temë kryesore ngritjen e vetëdijesimit për rëndësinë e ujit të pijes.

Instalimi i modulit për menaxhimin e ankesave të konsumatorëve

Kompania do të administrojë të gjitha ankesat dhe kërkesat e konsumatorëve dhe në një afat sa më të shkurtër ti shqyrtojë ato dhe ti përgjigjet konsumatorëve.

Me qëllim të zbatimit dhe shqyrtimit të ankesave të konsumatorëve do plotësohet dhe të organizohen trajnime të stafit të shërbimit me konsumatorë.

Me përmirësimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve kompania planifikon që të arrijë edhe përmirësimin e performancave sidomos në rritjen e numrit të konsumatorëve, rritjen e sasisë së faturimit, zvogëlimin e keqpërdorimeve, zvogëlimin e lidhjeve ilegale, dhe përmirësimin e inkasimit që është një ndër objektivat kryesore dhe të domosdoshme e kompanisë.


2.1 Planifikimi i numrit të konsumatorëve

Kompania ka paraparë një rritje të numrit të konsumatorëve prej **2.17%** në vit apo **590** konsumatorë. Ndërsa deri në vitin 2011, parashikohet një rritje prej 6.5% ku numri i konsumatorëve parashikohet të arrijë në **29080. (apo 1770 konsumatorë të rinj)**.

Kjo rritje e numrit të konsumatorëve planifikohet të arrihet duke përmirësuar shërbimin ndaj konsumatorëve por duke përmirësuar edhe efikasitetin e punës të punëtorëve të inkasimit dhe ekipes së kontrolles dhe asaj të shkyçjes.

Në këtë drejtim planifikohet që të riorganizohet (plotësohet) ekipa e shkyçjes dhe e kipa e kontrolles me qëllim të evidentimit dhe legalizimit të lidhjeve ilegale

	Nr. I Konsumatorëve	2007	2008	2009	2010	2011
1	Nr. i kons. shtëpiak (në fund të vitit)	22,814.0	23,246.0	23,786.0	24,326.0	24,866.0
2	Kyçjet o-shtëpiake (në fund të vitit)	4,014.0	4,064.0	4,114.0	4,164.0	4,214.0
	Nr. i kons. Gjithsej	26,828.0	27,310.0	27,900.0	28,490.0	29,080.0



2.2 Planifikimi i faturimit

Në kuadër të përmirësimit të shërbimeve ndaj konsumatorëve është e paraparë edhe faturimi real i ujit të shpenzuar.


Me qëllim të arritjes së këtij objekti do të merren këto masa konkrete:

- Evidentimi i saktë i konsumatorëve pa ujëmatës.
- Evidentimi i konsumatorëve me ujëmatës jo funksional.
- Caktimi i grupit të veçantë që do të merret vetëm me ndërrimin e ujëmatësve.
- Ujëmatësit jo funksional do të bazhdarohen dhe pastaj të riinstalohen konsumatorëve.
- Leximi i saktë i të gjitha ujëmatësve funksional. (rritja e kontrollës së leximit dhe marrja e masave ndëshkuese për mos lexim apo lexim qëllimisht të gabuar).
- Riorganizimi i shërbimit të veçantë vetëm për leximin e ujëmatësve.

Me implementimi e këtyre masave planifikohet të rritet shuma e faturuar në nga viti 2008 (7.523.436 m3) deri në vitin 2011 (8.034.159.2 m3) apo një rritje prej **6.8%**.

Faturimi në m3


	Faturimi në m3	2007	2008	2009	2010	2011
1	Kons. shtëpiak (m3)	7,256,297	7,397,236	7,553,339	7,726,787	7,900,235
2	Kons. jo-shtëpiak (m3)	126,832	126,200	128,725	131,298	133,924
	Gjithsej - m3	7,383,129	7,523,436	7,682,064	7,858,085	8,034,159



Faturimi në €

Me implementimin e masave të lartpërmendura parashikohet të arrihet një rritje e shumës së faturuar në Euro prej 160.960 apo një rritje prej 6.8% (2.367.115 në vitin 2008 - 2.528.075 në fund të vitit 2011)

	Faturimi në €	2007	2008	2009	2010	2011
1	Kons. shtëpiak €	2,205.914	2,248.759	2,296.214	2,348.942	2,401.671
2	Kons. jo-shtëpiak €	156.687	158.740	162.044	165.644	169.259
	Gjithsej - €	2,362,601€	2,407,499€	2,458,258€	2,514,586€	2,570,930€



Inkasimi ne € (Sipas tarifave ekzistuese)

Një ndër objektivat kryesore e kompanisë për vitin 2009 deri në vitin 2011 është rritja e të hyrave, respektivisht rritja e inkasimit. Kompania është e orientuar që të jetë financiarisht e vetë qëndrueshme dhe e aftë ti kryej të gjitha shërbimet e domosdoshme.


Në këtë drejtim janë paraparë masa konkrete të cilat do të rezultojnë në rritjen e inkasimit;

- Përmirësimi i shërbimeve ndaj konsumatorëve
- Trajnimi i stafit , me qëllim të përmirësimit të sjelljeve dhe kontakteve me konsumatorë
- Informimi i drejtë dhe me kohë i konsumatorëve
- Shqyrtimi i drejtë dhe në afat sa më të shpejtë i të gjitha ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve
- Leximi i rregullt dhe i saktë i ujëmatësve
- Faturimi sipas shpenzimit (Eliminimi i faturimit paushall)
- Kontaktet me konsumatorë me shumë të lartë të borxheve ndaj kompanisë (mundësia e nënshkrimit të kontratave për shlyerjen e borxheve me këste)
- Marrja e masave ligjore sipas Zyrës Rregullative (procedurat e shkyçjes)
- Forcimi i ekipeve të kontrolles dhe ekipeve për shkyçje
- Zgjidhja e rasteve sociale në bashkëpunim me institucionet tjera relevante

Kompania do të angazhohet dhe shpreson që gjatë vitit 2009 të inkasojë edhe borxhet e ndërmarrjeve të privatizuar.

Kompania ka paraparë që me implementim e masave të lartshënuara të arrijë një përmirësim të inkasimit në vitin 2009 në 71%, në vitin 2010 në 74 % dhe në vitin 2011 në 76 % , që në krahasim me vitin 2007 ku inkasimi ishte 65% deri në vitin 2011 parashikohet të ketë një rritje prej 11%


	Inkasimi në €	2007	2008	2009	2010	2011
1	Kons. shtëpiak €	1.408.102	1.519.631	1.623.831	1.734.905	1.823.578
2	Kons. jo-shtëpiak €	114.381	117.468	121.533	125.889	130.329
	Gjithsej - €	1.522.483€	1.637.099	1.745.364	1.860.794	1.953.907



Inkasimi në Euro sipas tarifave të planifikuara

Rritja e tarifave për ujë të pijes dhe kanalizim është kompetencë e Zyrës Rregullative, por kompania shpreson që në aplikimin tariforë të dorëzuar nga Kompania të miratohet një rritje e tarifave ekzistuese prej së paku 25%.

	Inkasimi në €	2007	2008	2009	2010	2011
1	Faturimi në m3	7,383,129	7,523,436	7,682,064	7,858,085	8,034,159
2	Faturimi në Euro (tarifat ekz.)	2,362,601	2,407,499	2,458,258	2,514,586	2,570,930
3	Faturimi në Euro (tarifat e plan.)		3.009.374	3.072.825	3.143.234	3.213.664
4	Inka. sipas tarifave ekzistuese	1.522.483	1.637.099	1.745.364	1.860.794	1.953.907
5	Inka. sipas tarifave të planifikuara		2.046.374	2.181.705	2.325.993	2.442.384
6	% e inkasimit sipas viteve	65%	68%	71%	74%	76%



MASAT E PLANIFIKUARA PËR ARRITJEN E OBJEKTIVAVE TË KOMPANISË

Me qëllim të përmirësimit të gjendjes financiare të Kompanisë janë planifikuar masa konkrete në përmirësimin e gjendjes aktuale:

- Përmirësimi i leximit të saktë të konsumit të ujit të pijes,
Marrja e masave ndëshkuese ndaj mos leximit apo leximit qëllimisht të gabuar.
- Zvogëlimi i faturimit paushall.
Vendosja e ujëmatësve tek konsumatorët pa ujëmatës apo ndërrimi i ujëmatësve jo funksional.
- Luftimi i keqpërdorimeve
Riorganizimi i ekipës së kontrollës
Marrja e masave ligjore ndaj kyçjeve të paligjshme.
- Përmirësimi i inkasimit.
Riorganizimi i zonave dhe kompensimit.
- Përmirësimi i raporteve Konsumatore-Kompani
- Përgatitja dhe realizimi i fushatave të vetëdijesimit të popullatës duke bashkëpunuar edhe me institucionet tjera. (Kuvendin Komunal, SHPK-ne, Gjykatat dhe Mediat)

Këto angazhime do ta sjellin kompaninë në një situatë që te arrije objektivat e prezantuara më poshtë për vitin 2009 - 2011.

OBJEKTIVAT E KOMPANISË PËR VITIN 2009 - 2011

	2007	2008	2009	2010	2011
UJI I PRODHUAR m ³	12057815	12.010.000	12.057.815	12.057.815	12.057.815
UJI I FATURUAR m ³	7.383.129	7.523.436	7.682.063	7.858.085	8.034.159
FATURIMI €	2.353.521	2.407.499	2.458.258	2.514.586	2.570.930
INKASIMI €	1.522.483	1.637.099	1.745.364	1.860.794	1.953.907
NR. I KONSUMATORËVE	26.828	27.310	27.900	28.490	29.080
KONS. E REGJISTRUAR	29.417	28.627	27.900	28.490	29.080
UJI I PA FATURUAR m ³	4.674.686	4.486.564	4.375.752	4.199.730	4.023.656
UJI I PA FATURUAR %	39%	37%	36%	35%	33%

3. PLANI OPERATIV

3.1 Aktivitetet kryesore operative jane:

- a) Furnizimi me uje ne sasi te mjaftueshme
- b) Furnizimi me ujë me cilesi dhe kualitet sipas standardeve
- c) Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit
- d) Servisimi i ujëmatësave
- e) Planifikimi mbi evitimin e humbjeve teknike
- ë) Matja e saktë e prodhimit dhe shpenzimit të ujit.
- f) Planifikimi i investimeve në rrjetin e ujësjellësit dhe Kanalizimit
- g) Planifikimi i zgjerimit të Shërbimeve
- h) Planifikimi i investimeve (afat shkurtë, afat mesëm dhe afat gjatë)

a) Kualiteti i ujit ;Detyra jonë primare është që uji të jetë i pastërt dhe nën kontrollë permanente nga ekipet tona të Kompanisë dhe me trajtim permanent 24 orë. Në raste të caktuara kur te kemi ndotje eventuale , ndërmerren masa dhe ndërpritet furnizimi si dhe njoftohen qytetaret me kohë. Në interes të kualitetit të ujit ne tani kemi bërë edhe planifikimin për të pas laboratorin tonë në kuader të Kompanis ku në çdo moment te kemi nën kontrollë kualitetin e ujit.

b) Furnizimi me ujë ; Detyrë dhe pergjegjësi e Kompanisë është që të kemi furnizim të rregullt me ujë , por në varesi të kapaciteteve dhe sistemit të furnizimit që kemi ndodh qe të kemi edhe reduktime të furnizimit me ujë . Plani i reduktimeve punohet dhe qytetaret i njoftojme me kohë për orarin e reduktimeve dhe për çdo ndryshim eventual i njoftojme qytetaret paraprakisht.Sistemi i furnizimit është 60% me ramje të lirë 40 %me pompim .

c) Mirëmbajtja e rrjetit të Ujësjellësit dhe Kanalizimit ; mirëmbajtja bëhet në mënyrë permanente dhe në varesi të defekteve , operativa është në gjendje gadishmerie 24 orë per të evituar këto defekte . Ekipa e detektimit është aktive dhe bën kontroll rrjetet në të cilat dyshohet se ka rrjedhje të ujit, ku është planifikue që për çdo muj të kemi (90-100) detektime, ku ndikon dukshem në evitimi e humbjeve të ujit.


d) Shërbimi i servisimit t ë ujmatësave ; Ky shërbim bën ekulibrimini e ujematësave Φ ($\frac{1}{2}$ - 100) mm të cilët vijne nga tereni si të dëmtuar dhe ne rastet kur konsumatori shpreh dyshimin se ujematësi bën matje jo reale . Kapaciteti ditor është ; Φ (15-40) mm (5-6) copë Φ (40-100) mm (2-3) copë

e) Planifikimi mbi evitimin e humbjeve ; Kompania disponon me rrjet që daton nga vitet e 60-ta ,sipas periudhave të ndyshme të ndërtimit , dhe nga materiale të ndyshme ku me kalimin e kohes janë dëmtuar dhe si retzulltat i këtyre dëmtimeve kemi edhe humbje teknike në rrjetin e ujësjellësit . Menagjeret Teknik të KUR të Kosovës kemi hartuar një plan strategjik për zvogelimin e humbjeve të ujit në KUR të Kosovës. Ky plan strategjik është prezentuar edhe per ditët e ujit në Kosovë . Tani jemi në fazen e implementimit të ketij plani në të gjitha Kompanitë e Kosovës ku parashohim uljen e humbjeve teknike dhe komerciale deri në 3 % me ç'rast do të ndikonte në furnizimin me uje gjatë 24 orëve.

Per vitin 2009 HIDROREGJIONI JUGOR ka paraparë një prodhim stabil mesatarisht prej 12.057.816 m3 në muaj apo 1.004.818 m3, duke shpresuar në mos ndryshimin e nivelit të burimeve të ujit të pijes.

Për vitin 2009 Kompania ka paraparë faturim mujor mesatar rreth 204.854 m3 apo rreth 2.458.248 m3 në vit. Ky parashikim është planifikuar të arrihet duke shtuar aktivitetet në leximin e ujëmatësave dhe zbulimin e lidhjeve ilegale.

2009	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Totali
Prodhim i m3	1004818	1004818	1004818	1004818	1004818	1004818	1004818	1004818	1004818	1004818	1004818	1004818	12057816
Faturimi m3	640172	640172	640172	640172	640172	640172	640172	640172	640172	640172	640172	640172	7682064
Humbjet e ujit (%)	36%	36%	36%	36%	36%	36%	36%	36%	36%	36%	36%	36%	36%



g) Planifikimi i zgjerimit të shërbimit : Kompania në politiken zhvillimore ka në plan edhe zgjerimin e shërbimeve edhe në pjesët tjera të fshatrave të cilat janë jashtë menagjimit të kompanisë. Me kualitetin e shërbimit dhe mirëmbajtjen që ju ofrojmë qytetareve kanë interesim Kuvendet Komunale që të gjitha fshatrat ku ka investuar Kuvendi Komunal të jenë nën menagjimin e Kompanisë "Hidroregjioni Jugor". Ne jemi në fazën e analizave të të gjitha kërkesave të ofruara për menagjim. Ne disponojmë me stafin dhe mekanizmin për të bërë një shërbim cilësor dhe efektiv. Parashohim që gjatë vitit 2009 të kemi rritje 1,5% të shërbimit.

Ne njesinë e Prizrenit planifikohet që ne të ardhmen të jenë në kuader të shërbimeve tona këto fshatra: Mamusha, Velezha, Korisha, Lubizhda dhe Hoqa e Qytetit. Me inkuadrimin e këtyre fshatrave do të rritet numri i konsumatorëve për 1200 konsumatorë.

Ne njesinë e Suharekës planifikohet që të inkuadrohen këto fshatra: Vraniqi, Studençani, Muhlani dhe Ternja. Me inkuadrimin e këtyre fshatrave do të rritet numri i konsumatorëve për 300 konsumatorë.

Ne njesinë e Malishevës planifikohet që të inkuadrohen këto fshatra: Bellanica, Bardhi, Guncati, Panorci dhe Terpeza. Me inkuadrimin e këtyre fshatrave do të rritet numri i konsumatorëve për 1173 konsumatorë.

Ne njesinë e Dragashit planifikohet që të inkuadrohen këto fshatra: Shajna, Brezna, Buçe dhe Bellobradi. Me inkuadrimin e këtyre fshatrave do të rritet numri i konsumatorëve për 785 konsumatorë.

h) Planifikimi i investimeve ; Në bazë të gjendjes momentale të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, sasise së ujit, shtimit të konsumatorëve, zhvillimit ekonomik, shtohen kërkesat për zgjerimin e rrjeteve dhe sasise së ujit. Në kuader të planifikimit ne kemi bërë edhe projekte ideore që janë të nevojshme për investime duke ju referuar parakushteve të cekura më lartë.

Ne tani kemi një plan zhvillimor të punuar duke u mbështetur edhe në donacionet e KFW ku vlera e projekteve të punuara është deri në 9 milion euro. (Shih aneksin e investimeve)

3.2 PLANI I MENAGJIMIT TË ASETEVE

NE duke pas parasysh gjendjen e tanishme të aseteve ,mendojm se nuk ka qenë një planifikim i mirëfillt në menagjimin e aseteve dhe gjendja e aseteve është në njëgjendje jo të kënaqshme . Asetet që tani kemi në shfrytëzim janë sipas periudhave të ndertimit ,para lufte ,pas lufte dhe tani janë një gjendje më të mirë .

Duke parë gjendjen e aseteve pas lufte janë bërë investime në rrjetet e ujësjellësve dhe kanalizimeve , Fazinerin,ujmatësa të profileve të ndryshme si dhe në mjetet e punës , ndihma me makineri në shtimin e sasis së ujit ,në Kualitetein e ujit Rezervare . . Të gjitha keto ndihma ,investime kan ndikue në permisimin e gjendjes së aseteve dhe performansën e Kompanive .

Tani kemi një menagjim më të mirë në Këmpani ,por ka ende për tu bërë .

Duke pas parasysh gjendjen e aseteve dhe analizave të bëra nga të dhënat e përditshme kemi percaktue Objektivat dhe prioritetet e projekteve.

Objektivat tona për të pas një menagjim më të mirë dhe kontrollë mbi asete janë;

- Zavendësimi i rrjetave rë vjetëruara të ujit dhe kanalizimit 5% për qdo vitë
- Standardizimi i procedurave të punës ,gjysme e vitit 2009
- Plotësimi i rregullatives së brendshme –adresimi më i mirë dhe më i saktë i përgjegjësive deri në fund të vitit 2009
- Planifikimi i resurseve njerëzore –trajniimet e nevojshme
- Shfrytëzimi i të gjitha veglave menaxhuese .
- Realizimi i projekteve sipas dinamikës së dhënë .



Nr	Emri i projektit	Buxheti i Planifikuar	2009	2009	2010	2010	2011	2011
			Buxheti i KRU PZ	Buxheti i jashtëm	Buxheti i KRU PZ	Buxheti i jashtëm	Buxheti i KRU PZ	Buxheti i jashtëm
1,1	Furnizimi me sofer WooterCad dhe Auto Cad	15000	15000					
1,2	Zëvendësimi dhe rehabilitimi i pompave PZ	10000	10000					
1,3	Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit Atmaxhe PZ	37000	37000					
1,4	Rehabilitimi i objektit te depos RE	28000	28000					
1,5	Ndërimi i valvulave-nyjet kryesore PZ	36000	36000					
1,6	Rivendosje e kapakve te kanalizi dhe leshusve PZ	20000	20000					
1,7	Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit SU	99180	37000	62180				
1,8	Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit Savrovë SU	30000	30000					
1,9	Rehabilitimi i objektit -kaptazhi në Radesh DR	7000	7000					
1,1	Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit DR	18000	18000					
1,11	Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit MA	18000						
1,12	Vendosja e pompave ne stacionin e njesive	250000		250000				
1,13	Ndërtimi i rezervuarit stabilizues V=300m3	49381		49381				
1,14	rehabilitimi i rrjetit φ300mm ACC ne PE φ315mm 10bar Kurill l=310m	28000		28000				
1,15	Ndërimi i sistemit Transportus, Unifikimi i furnizimit me energji elektrike - lidhja me gjenerator	99000		99000				
1,16	Injektimi i shkambive dhe izolimi i kap.VI-teme murin mbrojtës ,digjitalizimi i sistemit mbrojtës	87040		87040				
1,17	Paisje per detektim	45000		45000				
1,18	Rehabilitimi i stacionit të filtrimit	198598		198598				
1,19	Kyqja e Abi -eliffit dhe Perllanka	2424		2424				
1,2	rehabilitimi i rrjetit φ400mm ACCme L=3291m dhe φ600mm ACC me φ700mm me φ225 mm/10 bar.	1786104		286104		500000	150000	500000
1,21	Guri i ZI Ujësjellësi i ri me gravitet me L=17208m me PE φ315 mm/10 bar L=2473m me φ225mm/10bar.	1816266		316266	100000	500000		500000

1,22	Ndertesa e njesis SU	79779			79779		
1,23	Rehabilitimi i burimit savrovë me rrjet PE ϕ 225mm/10 bar me L=2x3500 mm	355000		355000			
1,24	Ndertimi i rrjetit Samadraxhë	100000			100000		
1,25	Ndertimi i rezervarit Pusi i Atit dhe rrjeti furnizues V=1000m3	423695		423695			
1,26	Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në Suharekë	99180		99180			
1,27	Paisjet elektro mekanike Pusi i atit , Topallnica , Fidanishte , rReshtan	53685		53685			
1,28	Kaptimi i ujit , Tubi furnizues dhe Rezervari V=500 Mushtisht.	573073			50000	200000	50000 100000
1,29	Ndertesa e Njesis MA	79779		79779			
1,3	Paisjet elektro mekanike , sigurimi i Rezervarit Malishevë	53600		53600			
1,31	Zgjerimi i rrjetit	78000		78000			
1,32	Rehabilitimi i sistemit te ujësjellësit egzistues DR	220000		220000			
1,33	Ndertimi i sistemit restelicë me L=22815m me ϕ 355mm /10bar	2214580			100000	714580	150000 900000
134	L aboratori per Kontrollin e ujit Regjion	50000		50000			
1,35	Ndertimi zyreve Regjionale	68598		48098			
1,36	Pjes rez.per ujëmatësia te vegjel dhe të mdhesj sisit mekan.	90800		90800			
1,37	Ujmatësia rajonal magnetik -induktiv	58656		58656			
1,38	Aparati per matjen e sasis së ujit mobil	12000		12000			
1,39	Kompezator per ujëmatësia	9740		9740			
	Suma --1	9237978					
	UJRA TË ZEZA						
2,1	Rehabilitimi i rrjetit të kanaliz. PZ	41000	41000				
2,2	Zgjerimi i rrjetit te kanalizimit Su	28000	28000				
2,3	Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit DR	12000	12000				
2,4	Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit MA	26000	26000				
2,35	Kanalizimi i Jashtem savrovë	21300				21300	
2,6	Ndertimi i kanalizimit per largimin e ujrave të zeza nga lumi suharekë	370572		250000		120572	
2,7	Impianti për përperpunimin e ujrave të zeza	38000000	23000	10000000	100000	9000000	7000000

2,8	Kolektori për largimin e ujrave të zeza nga lumbardhi -ana e majtë	414150			50000	182075	50000	132075
2,9	Kolektori për largimin e ujrave të zeza nga lumbardhi në anën e djathtë	1518810			50000	354700	50000	354702
	SHUMA -- 2	40390832						
	Shuma Totale	49669810						

Arsyeshmëria teknike dhe financiare e projekteve të lartshënuara janë të prezantuara në tabelat vijuese

ARSYETIMI I MJETEVË FINANCIARE – INVESTUESE – PERIUDHA E KTHIMIT

Nr	Pershkrimi teknik	Gjen.egzist	Gjendja e re	Diferenca	Parametrat ekonomik			
No		Current situa	New situation	Difference	Çmimi Price		Vlera e projek.	Amorti.(m,vit)
					€	70%	Amount proc.	Amort.(m,y)
1	Pompat me motor B-I dhe B-II	1267,7 kwh	1050,70 kwh	217 kwh	0,10€/kwh	131,242	250,000	1 vit/11muaj
2	Rezervuari "Bazhdarhana" V=300 m3 dhe sistemi I Filtrimit	70 l/sec 252 m3/h	110 l/sec 396 m3/h	40 l/sec 144 m3/h	€/ m3 1.20	174,182	247976	1 vit
	Rehabilitimi i rrjetit "Kurilla"	14 l/sec	10 l/sec	Humb. 4l/sec				5 muaj
3	Rehabilitation of network of Kurilla	50.4 m3/h	36 m3/h	Loses 14,4m3/h	0.20 €/ m3		28000	
